



**INFORMACION SIPAS RREGULLORES “PËR KËRKESAT MINIMALE TË
PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT NGA
BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA”**

(Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008, ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

Për periudhën e mbyllur më 31 Mars 2017

PËRMBAJTJA

- I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BANKËN.**
- II. INFORMACION MBI AKTIVITETET E BANKËS**
- III. STRUKTURA ORGANIZATIVE E BANKES**
- IV. RISQET DHE DREJTIMI I TYRE**
- V. KAPITALI RREGULLATOR DHE MJAFTUESHMERIA E KAPITALIT**
- VI. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL**
- VII. POLITIKAT E SHPERBLIMIT**

TABELA SHOQERUESE TE INFORMACIONIT

TABELA 1: TREGUES TË RENTABILITETIT,

TABELA 2: BILANCI KONTABEL:

TABELA 3: ZERAT JASHTE BILANCIT

TABELA 4: PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

**TABELA 5. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS SHPËRNDARJES
GJEOGRAFIKE**

**TABELA 6. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS TIPIT TË INDUSTRIISË DHËNË
REZIDENTEVE**

TABELA 7. TREGUESI I LIKUIDITETIT

TABELA 8. AKTIVET SIPAS MATURIMIT TE MBETUR

TABELA 9. PASIVET SIPAS MATURIMIT TE MBETUR

TABELA 10: KAPITALI RREGULLATOR

TABELA 11: MJAFTUESHMERIA E KAPITALIT

Tirane, 28 Prill 2017

I. Informacion i përgjithshëm mbi bankën

Alpha Bank A.E. – Dega e Tiranës u krijua në 1998 si degë e Alpha Bank A.E., Athinë, e cila është mëma e grupit të shoqërive Alpha Bank. Më 19 Dhjetor 2006 Këshilli Drejtues i Zyrës Qëndrore miratoi një ndryshim të emrit të Bankës në Alpha Bank – Albania (“Banka”). Selia e regjistruar e Bankës ndodhet në Rrugën e Kavajës, Qendra e Biznesit G – Kam, kati i 2^{të}, Tiranë, Shqipëri.

Banka është licensuar nga Banka e Shqipërisë për transferimin e pagesave, aktivitete të huasë dhe depozitimit, dhe aktivitete të tjera në përputhje me Ligjin “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” (Nr. 8365 datë 2 Korrik 1998, ndryshuar më 18 Dhjetor 2006) dhe me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” (Nr. 8269 datë 23 Dhjetor 1997). Banka ka një rrjet me 35 degë në të gjithë vendin (2016: 35 degë). Më 31 Mars 2017, Banka ka 413 punonjës (31 Dhjetor 2016: 416 punonjës)

II. Informacion mbi aktivitetet e bankës

Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.14, datë 29.02.2012 Banka u shndërrua nga degë në filial / bankë vendase dhe u liçensua në 17 Maj 2012 për kryerjen e veprimtarive bankare sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” duke marrë emrin Banka Alpha Albania sha.

Banka, në përputhje me liçencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë si dhe me kriteret e përcaktuara në Ligjin Bankar, mund të ushtrojë aktivitetet e mëposhtëme financiare:

- (1) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe hipotekore;
- (2) Faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare;
- (3) Qiranë Financiare;
- (4) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çeket e udhëtarit, çeket bankare dhe kartat e pagesës;
- (5) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetëorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i. instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, çertifikata të depozitave etj.);
 - ii. këmbim valutor;
 - iii. instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen;
 - iv. letra me vlerë të transferueshme;



- (6) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara në pikat 2 deri 5 si më sipër.
- (7) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit.
- (8) Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve.
- (9) Shërbim i kasave të sigurimit.
- 10) Ndërmjetësim në sigurime duke vepruar si broker në sigurime.




Tabela 1: TREGUES TE RENTABILITETIT TE BANKES

	Mars 2017	Dhjetor 2016	Shtator 2016	Qershor 2016	Mars 2016
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare * 100]	1.49%	1.57%	0.19%	2.67%	(0.84%)
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare	0.25%	0.06%	0.03%	0.03%	(0.01%)
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë	9.05%	10.67%	13.3%	12%	14%
4. Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	249%	194.28%	197.51%	248.59%	173%
5. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) [të ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar * 100]	18.22%	19.63%	2.34%	3.36%	(11.06%)
6. Aktive për punonjës [totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve] në Lek'000	170,463	169,618	162,221	152,792	150,665
7. Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare	2.86%	2.76%	2.57%	1.44%	1.88%
8. Të ardhurat nga interesat / aktivet mesatare	3.33%	3.39%	3.24%	1.78%	2.57%
9. Shpenzime për interesa / aktivet mesatare	0.48%	0.63%	0.67%	0.35%	0.69%
10. Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë	22.53%	20.72%	26.28%	25.3%	24.95%
11. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare	(0.03%)	0.00%	(0.34%)	(0.29%)	(0.24%)
12. Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë	25.38%	21.79%	30%	30.5%	36.24%
13. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë	8.26%	8.11%	11.29%	19.96%	13.92%
14. Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare	0.21%	(0.08%)	1.35%	1.37%	1.62%

TABELA 2. BILANCI
(000 lekë)

	Mars 2017	Dhjetor 2016	Shtator 2016	Qershor 2016	Mars 2016
Aktivitet					
Mjete monetare dhe vlera në Bankën Qëndrore	11,277,397	12,420,492	11,765,410	7,298,752	10,326,354
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	11,323,016	8,802,474	7,593,823	11,323,952	7,786,450
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	16,126,143	16,843,070	17,511,985	17,459,485	16,425,942
Letra me vlerë të mbajtura për investim	860,999	863,340	861,531	865,069	1,367,765
Hua dhe paradhënie klientëve	29,231,042	29,275,316	28,498,534	26,601,095	26,957,768
Aktive afatgjata materiale	76,142	81,124	83,565	75,111	72,443
Aktive jo-materiale	26,104	22,506	23,228	23,873	14,566
Aktive të tjera	1,480,431	2,252,566	1,470,352	1,442,229	1,382,719
Totali i aktiveve	70,401,274	70,560,888	67,808,429	65,089,567	64,334,008
Detyrimet					
Hua dhe paradhënie nga institucionet financiare	2,014,915	2,260,208	1,412,975	1,243,543	880,609
Detyrime ndaj klientëve	59,054,550	58,889,464	58,063,510	55,700,117	55,577,510
Detyrime të tjera	313,485	652,956	475,712	345,556	229,881
Fondi rezervë statistikor	473,373	548,830	484,786	425,736	382,784
Fondi rezervë të tjera	16,263	16,263	-	-	-
Fondi rezervë për detyrimet tatimore	6,971	6,966	6,310	6,310	6,310
Borxhi i varur	2,181,315	2,166,923	2,200,498	2,200,570	2,223,869
Totali i detyrimeve	64,060,871	64,541,610	62,643,792	59,921,832	59,300,964
Kapitali i paguar	10,960,120	10,960,120	10,960,120	10,960,120	10,960,120
Rezerva e rivlerësimit	(20,533)	(76,204)	48,472	56,133	146,093
Rezerva të tjera	817,483	817,483	787,493	787,493	787,493
(Humbje të akumuluarra)/fitime të mbartura	(5,416,668)	(5,682,121)	(6,631,448)	(6,636,011)	(6,860,662)
Kapitali aksioner	6,340,402	6,019,279	5,164,637	5,167,735	5,033,044
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner	70,401,274	70,560,888	67,808,429	65,089,567	64,334,008

TABELA 3. ZËRAT JASHTË BILANCIT
(000 lekë)

	Mars 2017	Dhjetor 2016	Shtator 2016	Qershor 2016	Mars 2016
ANGAZHIME FINANCI	1,995,058	2,144,676	1,918,593	2,156,752	2,090,599
Angazhime të dhëna	1,995,058	2,144,676	1,918,593	2,156,752	2,090,599
Klientëve	1,995,058	2,144,676	1,918,593	2,156,752	2,090,599
GARANCITË	58,022,827	56,453,915	56,326,993	55,559,549	56,081,055
Garanci të dhëna	386,781	368,437	347,384	493,738	492,462
Klientëve	386,781	368,437	347,384	493,738	492,462
Garanci të marra	57,636,046	56,085,478	55,979,609	55,065,811	55,588,593
Klientëve	57,636,046	56,085,478	55,979,609	55,065,811	55,588,593
ANGAZHIME TË TJERA	45,867	13,118	56,357	4,642	803
Të tjera	45,867	13,118	56,357	4,642	803
TOTALI	60,063,752	58,611,710	58,301,943	57,720,943	58,172,456

TABELA 4. PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(000 lekë)

	Mars 2017	Dhjetor 2016	Shtator 2016	Qershor 2016	Mars 2016
Të ardhura nga interesat	563,605	2,244,950	1,573,010	1,156,078	425,629
Shpenzime për interesa	80,790	418,368	323,954	224,071	113,938
Të ardhura neto nga interesat	482,815	1,826,582	1,249,056	932,007	311,691
Fitim/(humbje) neto nga veprimet me letrat me vlerë	252,235	859,863	752,289	364,311	196,851
Të ardhura neto nga komisionet	49,020	193,432	131,835	80,654	32,543
Fitimi neto nga transaksionet e shkëmbimeve valutore	12,511	40,387	28,717	19,126	10,044
Të ardhura totale operative	796,582	2,920,264	2,161,897	1,396,098	551,129
Shpenzime për punonjësit	177,015	714,885	536,686	353,346	173,832
Shpenzime për qira	59,260	247,623	182,369	115,242	57,684
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	23,773	105,532	80,371	54,782	27,946
Shpenzime të tjera operative, neto	141,098	852,668	615,830	342,812	162,152
Shpenzimet totale operative	401,145	1,920,707	1,415,255	866,182	421,614
Shpenzime për fondin rezervë për huatë dhe paradhëniet	218,316	(209,534)	563,722	410,609	277,812
Shpenzime/(rimarrje) për fondin rezervë statistikor	(75,457)	156,622	92,578	33,528	(9,424)
Shpenzime për fondin rezervë	142,859	(52,913)	656,300	444,137	268,388
Tatimi mbi fitimin	-	12,875	-	-	-
(Humbja)/fitimi neto për vitin	252,577	1,039,594	90,342	85,778	(138,873)

TABELA 5. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE

Huatë sipas rrethit ne '000 Leke	Rrethi Tiranë	Rrethi Durrës	Rrethi Elbasan	Rrethi Shkodër	Rrethi Korçë	Rrethi Vlorë	Rrethi Lushnjë	Rrethi Gjirokastrë
Hua afatshkurtër (deri në një vit)	4,999,414	277,728	72,311	1,174	65,993	201,782	2,456	467
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	235,713	9,591	1,197	495	641	2,286	413	467
Në valutë	3,820,376	198,314	18,783	51	58	193,533	143	-
Korporata jofinanciare private	3,813,108	185,343	18,644	-	-	193,533	-	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	7,268	12,971	139	51	58	-	143	-
Në lekë	489,826	51,651	197,288	24,196	46,945	46,202	15,046	14,018
Korporata jofinanciare private	222,863	14,030	155,660	7,415	26,370	18,390	2,741	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	266,963	37,621	41,628	16,781	20,574	27,812	12,305	14,018
Në valutë	1,619,794	55,536	21,178	-	3,012	43,740	5,290	22,476
Korporata jofinanciare private	1,325,897	50,301	19,644	-	3,012	41,391	4,227	19,154
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	293,897	5,235	1,534	-	-	2,349	1,063	3,323
Hua afatgjatë (mbi 5 vjet)	15,193,649	1,673,515	790,535	226,616	349,907	717,624	312,924	221,034
Në lekë	4,365,677	636,288	555,052	156,386	282,647	374,216	169,453	56,694
Korporata jofinanciare private	2,349,345	193,089	146,087	28,142	57,645	84,130	95,883	2,720
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	2,016,332	443,199	408,965	128,244	225,002	290,087	73,570	53,974
Në valutë	10,827,972	1,037,227	235,483	70,230	67,260	343,407	143,471	164,340
Qeveria qendrore	953,710	-	-	-	-	-	-	-
Korporata jofinanciare private	4,515,444	210,446	41,318	-	-	56,807	71	12,281
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	5,358,818	826,781	194,165	70,230	67,260	286,600	143,401	152,059
Totali	22,302,683	2,058,430	1,081,312	251,987	465,856	1,009,348	335,716	257,995

TABELA 5. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (VAZHDIM)

Huatë sipas rrethit ne '000 Leke	Rrethi Fier	Rrethi Berat	Rrethi Pogradec	Rrethi Sarandë	Rrethi Peshkopi	Rrethi Kukës
Hua afatshkurtër (deri në një vit)	9,604	161,905	12,130	9,615	13,968	10
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	564	525	379	285	721	10
Në valutë	-	17,105	-	0	-	-
Korporata jofinanciare private	-	6,837	-	-	-	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	-	10,268	-	0	-	-
Hua afatmesme (mbi 1 vit deri në 5 vjet)	68,865	95,845	19,229	12,675	21,278	4,640
Në lekë	62,580	68,456	18,902	12,370	21,025	4,640
Korporata jofinanciare private	20,334	42,824	6,714	7,510	8,575	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	42,245	25,631	12,189	4,861	12,450	4,640
Në valutë	6,285	27,390	327	305	253	-
Korporata jofinanciare private	6,285	25,267	-	-	-	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	-	2,123	327	305	253	-
Hua afatgjatë (mbi 5 vjet)	627,189	397,747	324,973	251,146	110,786	188,654
Në lekë	435,654	261,205	297,998	71,421	92,789	175,082
Korporata jofinanciare private	48,636	60,746	93,399	38,849	5,610	126,553
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	387,019	200,458	204,598	32,571	87,179	48,529
Në valutë	191,535	136,543	26,975	179,726	17,997	13,571
Korporata jofinanciare private	65,700	4,521	-	91,378	-	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	125,835	132,022	26,975	88,348	17,997	13,571
Totali	705,658	655,498	356,332	273,436	146,032	193,303

TABELA 5. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (VAZHDIM)

Huatë sipas rrethit ne '000 Leke	Rrethi Lezhë	Rrethi Burrel	Rrethi Përmet	Rrethi Librazhd	Rrethi Laç	Rrethi Bilisht	Rrethi Krujë	Rrethi Tepelenë
Hua afatshkurtër (deri në një vit)	5,366	3,124	14,693	67,058	8,280	17,368	204	1,671
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	330	3,124	303	5,915	1,241	445	204	1,671
Në valutë	9	-	-	3,280	1	0	-	-
Korporata jofinanciare private	-	-	-	3,280	-	-	-	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	9	-	-	-	1	0	-	-
Hua afatmesme (mbi 1 vit deri në 5 vjet)	41,665	41,866	5,860	37,210	25,295	18,755	75,635	11,803
Në lekë	27,278	41,866	5,860	29,579	11,971	11,966	37,387	11,383
Korporata jofinanciare private	19,883	1,341	3,241	13,754	375	-	27,029	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	7,395	40,525	2,620	15,825	11,595	11,966	10,358	11,383
Në valutë	14,387	-	-	7,631	13,324	6,789	38,248	421
Korporata jofinanciare private	14,003	-	-	6,244	12,812	6,789	35,290	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	383	-	-	1,387	512	-	2,958	421
Hua afatgjatë (mbi 5 vjet)	249,969	236,431	20,681	96,303	104,281	78,180	93,107	44,755
Në lekë	139,900	226,945	10,697	85,577	42,457	55,352	49,478	27,612
Korporata jofinanciare private	36,347	7,714	-	17,390	2,208	22,739	2,940	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	103,553	219,231	10,697	68,187	40,249	32,614	46,538	27,612
Në valutë	110,069	9,486	9,984	10,725	61,824	22,828	43,629	17,143
Korporata jofinanciare private	18,608	-	4,428	-	-	19,166	19,136	-
Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	91,461	9,486	5,556	10,725	61,824	3,661	24,493	17,143
Totali	297,000	281,421	41,234	200,571	137,856	114,303	168,945	58,229

TABELA 6. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS TIPIT TË INDUSTRISE DHËNË REZIDENTEVE

Huatë sipas aktivitetit ekonomik dhe rrethit ne '000 Leke	Rrethi Tiranë	Rrethi Durrës	Rrethi Elbasan	Rrethi Shkodër	Rrethi Korçë	Rrethi Vlorë	Rrethi Lushnjë	Rrethi Gjirokastrë
Korporata jofinanciare private	13,169,983	723,032	433,685	36,185	152,321	400,215	104,821	34,155
Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim	291,927	-	-	-	-	-	-	-
Industria nxjerrëse	2,557,944	-	34,436	-	10,004	-	189	-
Industria përpunuese	1,886,424	107,824	6,863	-	-	10,418	-	-
Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër te kondicionuar	269,224	-	50,898	-	-	3,325	-	-
Ndërtimi	2,523,577	37,864	38,211	-	-	10,628	17,285	-
Tregtia me shumicë dhe pakicë, Riparimi i automobilitave e motorcikletave.	4,280,822	411,968	190,854	18,215	128,205	294,259	29,755	21,874
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	156,060	4,585	36,544	6,125	-	45,567	57,591	12,281
Transport dhe Magazinim	614,653	56,203	-	5,017	14,112	24,566	-	-
Informacioni dhe Komunikacioni	104,347	-	-	-	-	-	-	-
Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet mbështetëse	7,288	-	-	-	-	-	-	-
Arsimi	83,211	25,672	-	-	-	-	-	-
Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	7,300	831	-	-	-	-	-	-
Art, Argëtim dhe zbavitje	-	1,063	-	6,829	-	-	-	-
Aktivitete të tjera shërbimi	387,204	77,022	75,880	-	-	11,451	-	-
Individë + Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	8,178,990	1,335,398	647,627	215,801	313,535	609,134	230,895	223,840
Hua konsumatore	1,463,857	296,979	248,436	96,879	74,194	167,932	27,966	51,163
Hua për blerje banesash	6,715,133	1,038,419	399,191	118,922	239,341	441,202	202,928	172,677
Totali	21,348,972	2,058,431	1,081,312	251,987	465,856	1,009,348	335,716	257,995

TABELA 6. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS TIPIT TË INDUSTRISË DHËNË REZIDENTEVE (VAZHDIM)

Huatë sipas aktivitetit ekonomik dhe rrethit ne '000 Leke	Rrethi Fier	Rrethi Berat	Rrethi Pogradec	Rrethi Sarandë	Rrethi Peshkopi	Rrethi Kukës
Korporata jofinanciare private	149,994	284,470	111,864	147,066	27,433	126,553
Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim	-	-	-	-	-	-
Industria nxjerrëse	-	-	-	-	-	-
Industria përpunuese	19,569	38,972	-	86,869	-	32,075
Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të kondicionuar	-	-	-	-	-	-
Ndërtimi	-	-	-	-	10,548	-
Tregtia me shumicë dhe pakicë, Riparimi i automobilave e motorcikletave.	124,726	229,927	107,888	52,687	16,885	69,902
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	5,699	11,051	3,976	-	-	24,577
Transport dhe Magazinim	-	-	-	-	-	-
Informacioni dhe Komunikacioni	-	-	-	-	-	-
Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet mbështetëse	-	-	-	-	-	-
Arsimi	-	-	-	-	-	-
Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	-	-	-	-	-	-
Art, Argëtim dhe zbavitje	-	-	-	-	-	-
Aktivitete të tjera shërbimi	-	4,521	-	7,510	-	-
Individë + Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	555,663	371,028	244,468	126,370	118,600	66,750
Hua konsumatore	159,433	132,039	73,445	13,146	83,815	13,247
Hua për blerje banesash	396,230	238,988	171,022	113,224	34,784	53,504
Totali	705,658	655,498	356,332	273,436	146,032	193,303

TABELA 6. KLASIFIKIMI I PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS TIPIT TË INDUSTRISE DHËNË REZIDENTEVE (VAZHDIM)

Huatë sipas aktivitetit ekonomik dhe rrethit ne '000 Leke	Rrethi Lezhë	Rrethi Burrel	Rrethi Përmet	Rrethi Librazhd	Rrethi Laç	Rrethi Bilisht	Rrethi Krujë
Korporata jofinanciare private	93,870	9,055	22,059	98,532	22,433	65,617	84,395
Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim	-	-	-	-	-	-	-
Industria nxjerrëse	4,402	-	-	-	-	-	-
Industria përpunuese	-	-	-	-	-	-	8,342
Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër te kondicionuar	-	-	-	7,476	-	-	-
Ndërtimi	17,247	-	-	-	-	-	6,562
Tregtia me shumicë dhe pakicë, Riparimi i automobilave e motorcikletave.	55,228	9,055	22,059	88,039	19,850	60,698	69,491
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	-	-	-	-	-	-	-
Transport dhe Magazinim	-	-	-	-	-	-	-
Informacioni dhe Komunikacioni	-	-	-	-	-	-	-
Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet mbështetëse	-	-	-	-	-	-	-
Arsimi	-	-	-	-	-	-	-
Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	-	-	-	-	-	-	-
Art, Argëtim dhe zbavitje	-	-	-	-	-	-	-
Aktivitete të tjera shërbimi	16,992	-	-	3,016	2,584	4,919	-
Individë + Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	203,131	272,366	19,175	102,039	115,423	48,686	84,550
Hua konsumatore	38,994	153,934	9,518	61,237	63,509	27,922	34,241
Hua për blerje banesash	164,137	118,432	9,657	40,802	51,914	20,764	50,310
Totali	297,000	281,421	41,234	200,571	137,856	114,303	168,945

IV. RISQET DHE DREJTIMI I TYRE

(a) Risku i likuiditetit

Drejtimi i likuiditetit dhe i riskut të likuiditetit bëhet në përputhje me politikat e brendshme të Bankës dhe të Grupit si edhe në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë Nr. 71 datë 14/10/2009 “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Gjatë tremujorit të parë të vitit, treguesit e likuiditetit të Bankës (të përlogaritur sipas kërkesave rregullatore të Bankës së Shqipërisë) kanë qenë vazhdimisht më të larta se nivelet minimale të kërkuara nga BoA. Në fund të muajit Mars 2017, aktivet likuide ishin 25,49 miliardë lekë ndërkohë që pasivet afatshkurtra ishin 57.74 miliardë lekë. Mesatarisht, gjatë tremujorit të parë, raporti i aktiveve likuide në lekë ndaj pasiveve afatshkurtra ka qenë afërsisht 36.44%. I njëjti raport për monedhat e huaja ka qenë rreth 49.31%. Treguesi total, i cili përfshin të gjitha monedhat ka qenë në një nivel shumë të kënaqshëm rreth 44.15% (*mund t'i referoheni tabelës numër 7*). Treguesit e likuiditetit të Bankës kalojnë në një proces periodik testim stresi sipas skenareve dhe supozimeve përkatëse. Rezultatet përkatëse të ushtrimit të stresuar gjatë tremujorit të parë të vitit, ashtu si edhe në tremujorët e tjerë, të gjithë skenarët treguan se Banka është në pozita të shëndosha likuiditeti.

Gjatë tremujorit të parë 2017, në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 71 “për Menaxhimin e Riskut të Likuiditetit”, Banka ka kryer ushtrimin e stresit të radhës, i cili tregoi situatën solide dhe likuide të Bankës dhe të gjithë treguesit janë në linjën e “gjelbër” (green area) edhe pas zbatimit të skenarëve përkatës të testit.

TABELA 7. TREGUESI I LIKUIDITETIT

Kodi	(000 lekë)	LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
A	TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE	8,436,177	1,228,776	15,342,400	483,860	25,491,214
B	TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT	23,151,897	1,917,655	32,182,786	486,944	57,739,283
C	TREGUESI I LIKUJDITETIT (në %)					
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEK)	36.44%				
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)	49.31%				
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)	44.15%				

TABELA 8. AKTIVET SIPAS MATURIMIT TE MBETUR

000 Leke	DITE				MUAJ			VITE		TOTALI
	1 (O/N)	2-7	8-15	16-30	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
VEPRIME ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	9,716,416	8,172,555	4,711,442	-	199,485	-	1,152	-	-	22,801,049
Arka	913,170	-	-	-	-	-	-	-	-	913,170
Llogari rrjedhëse në bankën qendrore	4,780,964	-	-	-	-	-	-	-	-	4,780,964
Rezerva të detyrueshme	871,821	-	4,711,442	-	-	-	-	-	-	5,583,263
Bono thesari	-	-	-	-	199,485	-	1,152	-	-	200,636
Llogari rrjedhëse në institucione financiare jo rezidente	2,712,637	-	-	-	-	-	-	-	-	2,712,637
Depozita në institucione financiare rezidente	-	2,167,484	-	-	-	-	-	-	-	2,167,484
Depozita në institucione financiare jo rezidente	437,824	6,005,070	-	-	-	-	-	-	-	6,442,894
VEPRIMET ME KLIENTËT	3,527,316	151,357	426	729,193	7,766	104,125	794,920	11,766,595	15,516,057	32,597,755
Hua standarte	3,397,295	136,362	383	49,366	5,859	102,693	784,217	7,165,113	10,755,859	22,397,146
- linje kredie	2,558,313	-	-	-	-	-	-	-	-	2,558,313
- kredi me keste	838,982	136,362	383	49,366	5,859	102,693	784,217	7,165,113	10,755,859	19,838,833
Hua në ndjekje	130,021	14,995	43	679,827	1,907	1,431	10,704	1,343,352	2,312,480	4,494,759
- linje kredie	17,718	-	-	-	-	-	-	-	-	17,718
- kredi me keste	112,303	14,995	43	679,827	1,907	1,431	10,704	1,343,352	2,312,480	4,477,041
Hua nënstandard	-	-	-	-	-	-	-	589,563	748,885	1,338,448
Hua të dyshimta	-	-	-	-	-	-	-	192,867	458,960	651,826
Hua të humbura	-	-	-	-	-	-	-	2,475,702	1,239,873	3,715,575
VEPRIME ME ADMINISTRATËN PUBLIKE	800	-	-	-	-	-	-	-	952,910	953,710
Kredi	800	-	-	-	-	-	-	-	952,910	953,710
TRANSAKSIONE TË LETRAVE ME VLERË	255,158	-	-	322,781	1,804,974	345,025	2,862,350	8,163,852	3,065,196	16,819,334
Letra me vlerë me të ardhura fikse (BONDE)	255,158	-	-	322,781	1,804,974	345,025	2,862,350	8,163,852	3,065,196	16,819,334
ASETE TË TJERA	976,072	-	-	-	-	-	-	46,742	597,621	1,620,436
I-TOTALI I AKTIVEVE	14,475,762	8,323,912	4,711,868	1,051,974	2,012,224	449,150	3,658,422	19,977,190	20,131,784	74,792,284

TABELA 9. PASIVET SIPAS MATURIMIT TE MBETUR

000 Leke	Dite									Totali
	1 (O/N)	2-7	8-15	16-30	1-3	Muaj 3-6	6-12	Vite 1-5	> 5	
VEPRIMET ME INSTITUCIONET FINANCIARE	396,362	1,618,553	-	-	-	-	-	-	-	2,014,915
Llogari rrjedhëse të bankës qendrore	369,388	-	-	-	-	-	-	-	-	369,388
Bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO	-	1,618,553	-	-	-	-	-	-	-	1,618,553
Llogari rrjedhëse të institucioneve financiare jo rezidente	26,311	-	-	-	-	-	-	-	-	26,311
Depozita të marra nga institucionet financiare jorezidente	664	-	-	-	-	-	-	-	-	664
VEPRIME ME KLIENTËT	20,939,312	581,841	802,021	2,013,417	4,884,079	12,430,990	15,656,109	1,690,164	-	58,997,932
Llogari rrjedhëse	12,213,652	-	-	-	-	-	-	-	-	12,213,652
Llogari depozitash pa afat	8,196,997	-	-	-	-	-	-	-	-	8,196,997
Llogari depozitash me afat	528,664	581,841	802,021	1,731,688	4,873,388	12,399,695	15,437,209	1,362,272	-	37,716,777
Llogari të tjera të klientëve	-	-	-	281,729	10,691	31,295	218,899	327,892	-	870,506
VEPRIME ME ADMINISTRATEN PUBLIKE	56,618	-	-	-	-	-	-	-	-	56,618
Llogari rrjedhëse	56,618	-	-	-	-	-	-	-	-	56,618
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DETYRIME TË TJERA	313,485	-	-	-	-	-	-	-	-	313,485
BURIMET E PËRHERSHME	57,368	3,110	8	1,124	129	2,289	17,409	988,094	7,948,793	9,018,324
I-TOTALI I PASIVEVE	21,763,146	2,203,503	802,029	2,014,541	4,884,207	12,433,279	15,673,518	2,678,258	7,948,793	70,401,274

(b) Risku i tregut

Risku i tregut është risku i reduktimit në vlerën ekonomike që rrjedh nga ndryshimet e pafavorshme të vlerës ose luhatshmërisë e normave të interesit, kurseve të këmbimit, indekseve të bursës, kapitaleve dhe mallrave.

Bordi Drejtues ia ka caktuar mbikëqyrjen e riskut të tregut Komitetit të Riskut dhe gjithashtu ka autorizuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve për miratimin e udhëzimeve dhe strategjisë për riskun e tregut.

Banka ka miratuar Politikën e Investimeve dhe respektivisht Limitet e Riskut të Tregut. Qëllimi i limiteve të riskut të tregut është të përcaktojë sasinë dhe rrezikun e mundshëm të tregut që rrjedh nga operacionet financiare të Bankës. Për më tepër, ajo siguron kornizën për aktivitetet që lidhen me tregun dhe përcakton rregullat, masat dhe kontrollet për menaxhimin e përditshëm të ekspozimeve që kanë të bëjnë me rrezikun e tregut. Gjatë 3-mujorit të parë 2017 nuk ka patur asnjë thyerje të limiteve të tregut.

(c) Risku operacional

Risku operacional është risku i humbjes së drejtëpërdrejtë ose të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, ashtu si edhe nga faktorë të jashtëm. Objektivi i Bankës është të mbulojë humbjet e pritshme dhe të papritshme që burojnë nga risqet operacionalë.

Drejtimi i riskut operacional bëhet në përputhje me politikat e procedurat e brendshme të Bankës, si edhe në përputhje me kërkesat e rregullores Nr. 03 datë 19/01/2011 “Për administrimin e rrezikut operacional”.

Në përputhje me kuadrin e brendshëm dhe atë rregullator, Banka ka zhvilluar procedura dhe sisteme të cilat bëjnë të mundur identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ngjarjeve të riskut operacional. Në vijim të këtij raportimi, bëhet klasifikimi i humbjeve bruto sipas linjave të biznesit si dhe analiza të mëtejshme. Gjithashtu, Banka ka zhvilluar edhe një raportim mujor të disa treguesve kyç të riskut operacional të cilat raportohen në Grup dhe në Bankë të Shqipërisë.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 ka vijuar projekti i Kontrollit të Riskut përmes procesit të Vet-vlerësimit, i cili zhvillohet në bazë vjetore, me të gjitha njësitë organizative të Bankës. Rezultatet dhe plani i veprimit analizohen periodikisht gjatë prezantimeve në Komitetin përkatës të Riskut Operacional, në kuadër të forcimit të mëtejshëm të masave parandaluese dhe atyre të zbutjes së riskut operacional.

Vitin e fundit, Banka ka miratuar një procedurë të veçantë për vlerësimin e çështjeve ligjore ku Banka është e përfshirë, duke i paraprirë risqeve që mund të burojnë nga këto çështje.

(d) Risku i kredisë

Drejtimi i riskut të kredisë bëhet në përputhje me politikat e brendshme të Bankës dhe të Grupit si edhe në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë Nr. 62 datë 14/09/2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë”.

Banka i ka kushtuar një vëmendje të veçantë riskut të kredisë duke zhvilluar procedura të ndryshme me anë të të cilave mund të identifikohet, vlerësohet dhe monitorohet risku i kredisë. Në strukturën e saj organizative, Banka ka zhvilluar struktura të ndryshme të cilat kanë përgjegjësi të mirëpërcaktuara qysh në fillimet e procesit të aplikimit për kredi, duke vijuar më tej me analizën dhe paraqitjen e aplikimit në komitetet përkatëse. Proçesi i analizës dhe aprovimit i nënshtrohet parimit të katër syve si nga njësitë e biznesit ashtu edhe nga ato të kreditit. Proçesi i monitorimit në vazhdimësi kryhet nga njësitë përkatëse e përmendura më sipër, si dhe nga njësia e menaxhimit të riskut për portofolin në tërësi.

Gjithashtu, Banka, me mbështetjen e Grupit, ka zhvilluar dhe njëkohësisht përdor përgjatë procesit të aprovimit të kredisë teknikat e klasifikimit të brendshëm. Më konkretisht, Banka përdor modele të klasifikimit të brendshëm për klientët e biznesit, si dhe modele të pikësimit për produktet ofruar klientëve individë.

Banka përlogarit fonde rezervë në bazë të rregullave të percaktuara në Rregulloren Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë”

Për çdo kategori të rrezikut, aplikohen normat minimale të fondeve rezervë si më poshtë:

Lloji i huasë	Norma e fondit rezervë
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Të ristrukturuara nga performuese (standarde dhe në ndjekje)	10%
Nën-standarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

**(e) Rreziku i normës së interesit**

Banka ka rrezik nga norma e interesit nga aktiviteti i saj financiar, kryesisht në formën e ekspozimit ndaj ndryshimeve negative në normat e interesit të tregut. Aktivitet dhe detyrimet ndahen në grupet kohore sipas datave të tyre të rivlerësimit për instrumente të normës së interesit variabel ose sipas datën e maturimit, për instrumentet me interes fikse.

Rreziku i normës së interesit vjen për shkak të korelacionit jo të persosur mes maturitetit (për normat fikse të interesit) ose dates së ri-cmimit (për normat variable të interesit) të aktiveve dhe detyrimeve që mbartin interes, levizja e pafavorshme e përrjesise dhe formes së kurbes së kthimit (levizja jo paralele e kthimit të normës së interesit për aktivitet dhe detyrimet që mbartin interes).

Aktivitetet manaxhuese të aktiveve dhe detyrimeve janë kryer në kontekstin e analizës së ndryshimeve ndaj ndryshimeve në normën e interesit. Banka zakonisht jep kredi me normë interesi të ndryshueshme sipas politikave të Bankës me normë të indeksuar (e cila bazohet në normat referencë si bono thesari, EURIBOR, LIBOR, etj.). Nga ana e depozitave, Banka ofron kryesisht produkte me normë interesi fikse. Banka është e ekspozuar ndaj një sërë risqesh të cilat lidhen me luhatjet në normat e interesit në treg për pozicionin e saj financiar dhe flukset e parave.

Forma totale e IRRBB-s		Totali i pozicioneve të ponderuara	
IRR		Monedha	Shuma
		1	2
2.	NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPOZIMIT		488,093,530.43
3.	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		6,677,232,450
4.	(NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPOZIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100		7.3098
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 1	ALL	258,806,173.09
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 2	USD	-22,736,205.99
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 3	EUR	263,647,325.83
1.4.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 4	GBP	0.00
1.5.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 5	CHF	0.00
1.6.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 6	CAD	0.00
1.7.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 7	SEK	0.00
1.8.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 8	AUD	0.00
1.9.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 9	JPY	0.00
1.10.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 10	DKK	0.00
1.11.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 11	NOK	0.00
1.12.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 12	TRY	0.00
1.13.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 13	XAU	0.00
1.14.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 14	CNY	0.00
1.15.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 15	OTHER	-11,623,762.50

**V. KAPITALI RREGULLATOR DHE MJAFTUESHMERIA E KAPITALIT**

Kapitali i autorizuar, emetuar dhe paguar plotësisht përbëhet nga 100% pjesëmarrje e Alpha Bank A.E., Athinë.

Kosto historike e kapitalit të paguar të Bankës përbëhet nga 10,080,000 USD, ekuivalent me 1,084,003 mijë Lek dhe 71,152,499 Eur ekuivalent me 9,876,117 mijë Lek.

Kapitali rregullator i bankës më 31 Mars 2017 është 6,677,232 mijë lekë (*mund t'i referoheni tabelës 10*)

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit rregullator mbi aktivet dhe zërat "jashtë bilanci" të ponderuara me risk, i shprehur në përqindje. Në 31 Mars 2017 Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 16.34%

TABELA 10: KAPITALI RREGULLATOR

Nr.	Zëri	Shuma (000 lekë)
1	<u>KAPITALI RREGULLATOR</u>	6,677,232
1.1	KAPITAL I NIVELIT TE PARE	5,009,177
1.1.1	KAPITAL BAZE I NIVELIT TE PARE	5,009,177
1.1.1.1	Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)	10,960,120
1.1.1.1.1	Kapitali i paguar	10,960,120
1.1.1.2	Fitimet e pashpërndara*	(6,721,790)
1.1.1.2.1	Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	(6,721,790)
1.1.1.2.2	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	-
1.1.1.3	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	817,483
1.1.1.4	Diferenca rivlerësimi kreditore	(20,533)
1.1.1.7	(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	(26,104)
1.1.1.7.1	(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara	26,104
1.2	KAPITALI I NIVELIT TE DYTE	1,668,056
1.2.1	Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë	1,668,056
1.2.1.1	Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur	1,668,056
1.2.1.2	Zëra memorandumi: Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur jo i njohur	513,259

Në llogaritjen e Kapitalit Rregullator nuk është përfshirë fitimi për fund vitin 31 Dhjetor 2016. Në përputhje me Rregulloren Nr.69, datë 18.12.2014, "PËR KAPITALIN RREGULLATOR TË BANKËS" Alpha Bank Albania do të përfshijë fitimin e fund vitit 2016 si element të kapitalit bazë me t'u miratuar nga eksperti kontabel.



Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	Shuma	
(në mijë lekë)		
1. Kapitali rregullator	(a)	6,677,232
2. Aktivët dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(b)	40,873,047
3. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (2/1)*100	((a)/(b))*100	16.34%

VI. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Bazat e përgatitjes

Të dhënat financiare janë paraqitur në Lek, rrumbullakosur në mijëshen më të afërt përveç rasteve kur tregohet ndryshe, dhe janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike, përveç letrave me vlerë për tregtim të cilat janë matur me vlerën e drejtë. Monedha funksionale e Bankës është Lek.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar me kursin e datës së raportimit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përveç kapitalit të paguar dhe rezervave, janë konvertuar me kursin në datën e transaksionit.

Kapitali i paguar në monedhë të huaj njihet fillimisht me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në fund të vitit konvertohet me kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e konvertimit njihen në rezervën e rivlerësimit e cila është pjesë e kapitalit të Bankës.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në bazë përlllogaritjeje.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat lidhen me shërbimet bankare si transferimet e fondeve, aktiviteti huadhënës, tarifa e mbajtjes së llogarive dhe garancitë bankare.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin kur kryhen shërbimet me të cilat ato lidhen.

(e) Tatim fitimi

Banka e përcakton tatimin vjetor në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor, llogaritur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), që mund jetë mjaft i ndryshëm prej raportimit për qëllime rregullatore në përputhje me MRF.

Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi para tatimit sipas SNRF për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërave që nuk taten apo njihen si të zbritshëm asnjëherë. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit sipas SNRF për të ardhura dhe shpenzime të caktuara, siç kërkohet nga legjislacioni Shqiptar.

Tatimi aktual llogaritet duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit dhe merr në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar.

(f) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe gjendje të pakushtëzuara në Bankën Qendrore. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përbëhen nga mjetet monetare dhe të tjera mjete të përshkuara si më sipër si dhe nga aktive me likuiditet të lartë me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jodomethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

(g) Letra me vlerë të tregtueshme

Letra me vlerë të tregtueshme janë ato letra me vlerë të cilat Banka i ka blerë kryesisht për qëllimin e shitjes në periudhë afatshkurtër. Letrat me vlerë të tregtueshme njihen fillimisht me çmimin e tyre të përfutur, përfshi shpenzimet dhe çdo interes të përlogaritur. Në çdo datë raportimi letrat me vlerë maten me çmimin më të fundit të tregut. Të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhura apo shpenzime.

Banka rishikon klasifikimin e letrave me vlerë të tregtueshme në çdo datë bilanci. Në vijim dhe pasi janë mbajtur gjashtë muaj në këtë kategori, letrat me vlerë klasifikohen përgjithmonë nga letra me vlerë të tregtueshme në letra me vlerë të vendosjes, ose letra me vlerë të investimit dhe maten me çmimin e tregut në datën e riklasifikimit.

(h) Letrat me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë ato letra që Banka i ka përfutur me synim mbajtjen e tyre për një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të atyre letrave me vlerë për të cilat Banka synon t'i posedojë deri në datën e maturimit dhe të cilat kënaqin rregullat që kanë të bëjnë me letrat me vlerë të investimit. Letrat me vlerë të vendosjes gjithashtu përfshijnë ato letra me vlerë të cilat nuk mund të regjistrohen si letra me vlerë të tregtueshme apo si letra me vlerë të investimit.

Letrat me vlerë të vendosjes regjistrohen në datën e përfutur me çmimin e tyre të përfutur përjashtuar shpenzimet. Në çdo datë raportimi, krijohen fonde rezervë kundrejt humbjeve kapitale të porealizuara që rezultojnë nga diferenca midis vlerës kontabël dhe çmimit të tregut të letrave me vlerë. Fitimet kapitale të porealizuara nuk regjistrohen.



(i) Letra me vlerë të investimit te mbajtura deri ne maturitet

Investimet në letra me vlerë te mbajtura deri ne maturitet përfshijnë bono thesari dhe obligacione qeveritare të blera me qëllimin dhe aftësinë e mbajtjes së tyre deri në maturim.

Letrat me vlerë të investimit regjistrohen në ditën e blerjes dhe fillimisht maten me çmimin e përfuturit, përjashtuar shpenzimet. Në datat raportuese ato maten me kosto të amortizuar, duke i zbritur fondin rezervë për mbulimin e humbjeve që krijohet për të mbuluar rrezikun e mospërbushjes së detyrimit nga ana e emetuesit të letrave me vlerë.



VII. POLITIKAT E SHPERBLIMIT

Politika e shpërblimit

- I. Politika e shpërblimit synon të sigurojë barazinë e brendshme dhe konkurrencën me tregun së bashku me mirëmbajtjen, angazhimin dhe motivimin e punonjësve. Kjo politikë zbatohet për të gjithë personat e punësuar nga Banka.
- II. Organet kompetente të Bankës mbajnë përgjegjësinë për rishikimin dhe përcaktimin e pagës fikse, pagës së ndryshueshme (kur është e aplikueshme) dhe përfitimet e anëtarëve të Bordit Drejtues, si dhe të "pozicioneve të ndjeshme" sipas rekomandimeve përkatëse të Bankës.
- III. Bordi i Drejtorëve (BD) mban përgjegjësinë përfundimtare për miratimin përfundimtar të pagës fikse, pagës së ndryshueshme (sa herë që është e aplikueshme) dhe përfitimet e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe "pozicioneve të ndjeshme" të tjera.
- IV. Në përgjithësi, struktura e shpërblimit të Bankës është kombinim i elementeve fikse dhe të ndryshueshëm (kur është e aplikueshme), si dhe të një sërë përfitimesh. Për të qenë konkurrent në treg dhe për të parandaluar riskun pertej tolerencës së lejuar nga Banka, është marrë në konsideratë ekuilibri i duhur midis elementeve fikse dhe atyre të ndryshueshme të shpërblimit.

Paga bazë

Paga bazë përfaqëson elementin fiks të shpërblimit dhe pasqyron pozicionin e individit, performancën dhe rritjen e njohurive dhe aftësive. Në rast të ndryshimeve të rëndësishme në përgjegjësinë e pozicionit ose në kushtet e tregut mund të aplikohet ndryshimi i saj.

Paga e ndryshueshme

Paga e ndryshueshme përfaqëson elementet e ndryshueshme të shpërblimit, të cilat janë fakultative dhe mund t'i referohen skemave vjetore të bonuseve dhe programeve të tjera nxitëse të cilat mund të ndryshojnë nga viti në vit. Këto lloje kompensimi, kur jepen, bazohen në performancën individuale së bashku me atë të Njesisë dhe performancës së Bankës. Kompensimi i ndryshueshëm bazohet mbi 'Treguesit kryesorë të Performancës' së bashku me masat cilësore, duke përfshirë respektimin e politikave, cilësinë e shërbimit, kënaqësinë e klientit dhe zhvillimin e njerëzve.

Përfitimet

Elementet fikse dhe të ndryshueshme të shpërblimit përbëhen nga një sërë përfitimesh që ndjek trendet e tregut lokal dhe kuadrin përkatës të grupit. Përfitimet mund të lidhen me pozicione specifike bazuar në hierarkinë e tyre brenda Bankës ose mund të përfaqësojnë politikën sociale ndaj punonjësve.

Objektivat e politikës së shpërblimit:

- Lidh shpërblimin me performancën e qëndrueshme në nivel korporativ dhe individual
- Lidh pagën me performancën jo vetëm në aspektin e arritjes së objektivave financiarë, por edhe në lidhje me respektimin e kuadrin të brendshëm institucional, cilësinë, kënaqësinë e klientit dhe zhvillimin e burimeve njerëzore
- Rregullon koston e punës me prioritetet e biznesit dhe kufizimet e kostos
- Tërheq dhe angazhon fuqinë punëtore të talentuar
- Siguron barazinë e brendshme dhe qëndrueshmërinë e pagës
- Lidh pagën me peshën relative të çdo pozicioni të veçantë në Bankë
- Reflekton pozicionin, aftësitë, njohuritë dhe performancën e individit
- Ndërlidh ndryshimin e pagës me ecurinë dhe zhvillimin individual

Alpha Bank Albania ka rishikuar politikën e shpërblimit gjatë vitit 2016.

Drejtorja e Alpha Bank Albania është përgjegjëse për:

- miratimin e politikave të Bankës për nivelet e pagave
- miratimin e përqindjes mesatare për rishikimin e pagave (duke përfshirë përshtatjen, sipas meritave dhe sipas tregut), së bashku me buxhetin e shpenzimeve të personelit,
- miratimin e matricës së planifikimit të pagave
- finalizimin dhe miratimin e rregullimeve të pagave individuale, me përjashtim të atyre të anëtarëve të saj
- miratimin (vendimi i fundit) lidhur me rritjen e pagës jashtë ciklit ose përcaktimin e nivelit të ri të pagës jashtë ciklit.

Bordi i Drejtorëve të Alpha Bank Albania ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin përfundimtar të:

- Politikës së shpërblimit që siguron përputhjen me parimet, kuadrin dhe udhëzimet e shpërblimit të Grupit
- Pagës fikse, pagës së ndryshueshme (sa herë që është e aplikueshme) dhe përfitimet e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe të tjera "pozicione të ndjeshme", sipas rekomandimeve të organeve kompetente.

Banka në bazë vjetore merr dhe përpunon të dhënat e studimit të tregut nga një agjenci e pavarur në lidhje me politikat e shpërblimit. Masat kryesore që Banka merr parasysh për këto risqe, duke përfshirë risqet e vështira për t'u matur dhe ndikimi i tyre në pagat dhe politikat e shpërblimit.

Vlerësimi i performancës:

Për vlerësimin e performancës dhe pozicionimin në rangun e pagave (paga e individit kundrejt politikës së Bankës), Banka merr në konsideratë dy dimensione. Matrica e planifikimit të pagave, në aspektin e përqindjeve, e cila paraqet mënyrën se si buxheti i aprovuar për rritjen e pagave shpërndahet tek punonjësit, duke marrë parasysh vlerësimin individual të performancës së bashku me pozicionimin e pagës individuale

	Pozicionimi ne rangun e pagave					
Vlerësimi i performancës	0-65%	65-80%	80-89%	90-110%	110-120%	>120%
Shkëlqyeshëm						
Tejkalon pritshmëritë						
Plotëson pritshmëritë						
Ka nevojë për përmirësim						
Poshtë pritshmërive						

- Masat që zbaton banka për të rregulluar politikat e shpërblimit në rast se performanca financiare është negative.

Për të marrë informacion mbi të dhënat e tregut, Banka merr pjesë në studime të ndryshme në lidhje me kompensimet dhe përfitimet të kryera nga



firma konsulente me reputacion. Në këtë mënyrë realizohet qasja e menjëhershme në rezultate dhe publikimet përkatëse.

Prandaj, krahasimi i pozicioneve të punës së Alpha Bank Albania me pozicionet përkatëse në treg bëhet e lehtë, duke ofruar në të njëjtën kohë një mjet të besueshëm për ndermarrjen e veprimeve korrigjuese.

Për të siguruar konkurrencën e tregut, politika e shpërblimit rishikohet në mënyrë sistematike, sipas vlerësimit të tregut mbi kompensimet dhe përfitimet.

Është praktikë e zakonshme marrja pjesë në anketa të kryera nga ofrues të besueshëm, mbi kompensimet dhe përfitimet. Rezultatet e sondazhit rishikohen për të qenë të informuar mbi tendencat e tregut dhe pozicionimin e Bankës duke u krahasuar me institucionet përkatëse.

- Informacion përmbledhës mbi mënyrat në të cilat banka lidh objektivat me performancën afatgjatë në nivelin e shpërblimit.

Vlerësimi i performancës të secilit punonjës, si rezultat i zbatimit të sistemit të vlerësimit të performancës nga Banka, ndërton një nga parametrat për llogaritjen e shpërblimit të tij /saj.

Në lidhje me vendimet për çështjet e kompensimit, merret parasysh vlerësimi i performancës në nivel Banke, Njësie dhe individuale.

Vlerësimi i performancës në lidhje me shpërblimin vendoset në një plan afatgjatë, me qëllim që të sigurohet se procesi i vlerësimit është bazuar në një performancë afatgjatë dhe se pagesa e shpërblimit në lidhje me performancën shpërndahet brenda një periudhe kohore gjatë të cilit mund të merren parasysh cikli i aktivitetit ekonomik ekzistues dhe risku i biznesit.

- Informacion mbi format e shpërblimit të ndryshueshëm që përdoren nga Banka dhe bazat e përdorimit të këtyre formave.

Paga e ndryshueshme përfaqëson elementet e ndryshueshme të shpërblimit, të cilat janë fakultative dhe mund t'i referohen skemave vjetore të bonuseve dhe programeve të tjera nxitëse të cilat mund të ndryshojnë nga viti në vit. Këto lloje kompensimi, kur jepen, bazohen në performancën individuale së bashku me atë të Njesisë dhe performancës së Bankës. Kompensimi i ndryshueshëm bazohet mbi 'Treguesit kryesorë të Performancës' së bashku me masat cilësore, duke përfshirë respektimin e politikave, cilësinë e shërbimit, kënaqësinë e klientit dhe zhvillimin e njerëzve.



- Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë

Personeli me ndikim të konsiderueshem në profilin e riskut mund të përfshihet në një skemë të ndryshueshme të shpërblimit me karakteristika të veçanta në lidhje me kohën dhe menyren e pagesës.

Perimetri i roleve me një profil rreziku është përcaktuar si më poshtë:

- Anëtarët e Këshillit Drejtues
- Anëtarët e Drejtorisë
- Kryetarët e Funksioneve të Kontrollit të Pavarur, pra:
 - Drejtimi i Riskut
 - Përputhshmëria
 - Kontrolli i Brendshëm.